

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, i përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.T., me vendbanim në fshatin R., Komuna e P. për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.619/11 të dt.27.12.2018 mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, më dt.13.02.2019 në praninë e Prokurores së Shtetit Ajshe Ferati, të dëmtuarit N.U. dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë në prezencë të palëve mori, publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

B.T. nga i ati P. dhe e ëma H., mbiemri i vajzërisë së nënës M., i lindur më datë *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin R., Komuna e P., ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, i pa punë, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 06.01.2011, rreth orës 10:08 në fshatin L., Komuna e P. me forcë ka tentuar ta pengoj zyrtarin e APK-së-të dëmtuarin N.U. i cili kishte hipur në rimorkio të traktorit të pandehurit për ti zbarkuar drutë e konfiskuara, i pandehuri ka hipur në rimorkio ku ndodhej i dëmtuari, e ka kapur me dy duar për ta penguar, me ç'rast të dy janë rrëzuar nga rimorkio në tokë dhe nga rrëzimi i dëmtuari ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Me këtë ka kryer veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 47, 73, 74 dhe nenit 409 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453, 463 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të akuzuarin B.T. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim do ta vuaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertizën Mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 30.66 Euro (tridhjetë Euro e 66 cent), për shpenzimet e paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/Euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë/Euro), në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjykata konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 500€ (pesëqind/Euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se nuk e paguan atëherë dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 46 të KPRK-së.

I dëmtuari N.U.-zyrtar i APK-së nga fshati D. e E., Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.619/11 të dt.27.12.2018 kundër të akuzuari B.T., me vendbanim në fshatin R., Komuna e P. për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 13.02.2019, gjatë të cilës prezantuan Prokurorja e Shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i dëmtuari N.U. si dhe i akuzuari.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë, më vjen keq që ka ndodhur rastu, nuk kam pasur qëllim që të lëndoj të dëmtuarin që as nuk e kam njohur, edhe këtu i kërkoj falje, me familjen U. jemi rregulluar dhe kam dëshmi ku ndërmjetsues kanë qenë dy njerëz të njohur në Llap, lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i njejtë është në pajtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazë të nenit 248 të KPPRK-së.

I dëmtuari N.U. në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se i bashkangjitem ndjekjes penale dhe parashtoj kërkesën pasurore-juridike dhe kërkoj nga gjykata që të dënohet sipas ligjit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, të dëmtuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet i akuzuari, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, janë pajtuar me të dëmtuarin sipas traditave dhe zakoneve tona, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.820/2018 me dt.13.02.2019

Sekretare Juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.